DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
Nr. 20357 Prot.
Datë 28.10.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANËS DURRËS

Nr. 18852 Prot. Durrës, më 27/10/2026

Lënda: Kërkesë për Shpallje Publike

Drejtuar: **DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE**
DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE

Në vijim të masave të ndërmarra për rikuperimin e borxhit doganor, mbështetur në Ligjin nr. 102/2014, "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, në Udhëzimin nr. 15, datë 03.12.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, "*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*", Kreu VI, "*Njoftimi i Vendimit*", pika 3, shkronja "b", "*Rastet e mosmarrjes së konfirmimit të njoftimit*", si dhe në zbatim të neneve 130–141/a të Kodit të Procedurës Civile, ju drejtohemi me kërkesën për të mundësuar njoftimin/shpalljen online, në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të subjektit/shtetasit debitor të përcaktuar më poshtë.
Ky njoftim kërkohet pasi, pavarësisht masave të ndërmarra nga ana jonë, nuk është bërë e mundur realizimi i njoftimit të drejtpërdrejtë të subjektit/shtetasit debitor, në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Për sa më sipër, lutemi për marrjen e masave përkatëse për publikimin e njoftimit online në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me qëllim vijimin e procedurave ligjore për rikuperimin e detyrimit doganor të papaguar.

Lajmerimi për Ekzekutim Vullnetar të Urdherit të Ekzekutimit:

Nr	Vendimi Administrativ		URDHERI I EKZEKUTIMIT		Subjekti debitor		Detyrimi	Penalitete	SHUMA
	Nr.	Data	Nr.	Data	Emri	Nipti			
1	29	12.01.2026	2299	29.05.2026	ARTEG MASTER	M26327203A	64,269	-	64,269
2	610	19.09.2025	1019	27.03.2026	OUTOMA	M02415010S	1,878,420	3,756,840	5,635,260
3	723	01.10.2025	2304	15.05.2026	ERDI CENA & A	I90417078U &	-	360,256	360,256
4	846	17.11.2025	2298	29.05.2026	FAM GAS	M21410502J	308,517	925,551	1,234,068

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

KRYETAR

Drilon Bushati